



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Seksioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit

Më 20.3.2013, në orën 10:00

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, kryetar, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini dhe Gëzim Kelmendi, anëtarë.

Nga Zyra mbështetëse morën pjesë: Fehmi Hyseni dhe Advie Morina;

Mbledhjen e kryesoi Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Nënkomisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

Armend Zemaj theksoi se Nënkomisioni, e ka përfunduar punën si Komision FunkSIONAL, sa i përket Rregullores së Kuvendit të Kosovës. Ka qenë e diskutueshme nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa, çështja e implikimeve buxhetore të kësaj rregulloreje.

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, duke u bazuar në përfundimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, të datës 28.8.2012, ka kërkuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të bëjë përlogaritjen e implikimeve buxhetore të Rregullores së Kuvendit.

Drejtoria për Buxhet dhe Pagesa, ka bërë analizën e implikimeve buxhetore për zbatimin e Rregullores së Kuvendit.

Pas analizave që i janë bërë projektregullores në shqyrtim, kemi arritur në përfundim se me ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Rregulloreje, nuk do të ketë implikime shtesë financiare, të cilat do ta ngarkojnë buxhetin e shtetit. Të gjitha implikimet janë të parapara në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 27.2.2013, shqyrtoi Projekt-rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe vlerësoi se Projekt-rregullorja nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Komisioni shqyrtoi edhe amendamentet e propozuara nga Komisionin Funkcional për Legjislacion, dhe vlerësoi se amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Në fund Nënkomisioni nxori këtë :

P ë r f u n d i m

Nënkomisioni për Mandat, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit të Kosovës, miratoi rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projekt-rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe rekomandimin e Drejtorisë për Buxhet dhe Pagesa. Të njëjtën e procedoi në Komisionin për Legjislacion për procedim të mëtejshëm në seancën plenare.

Të ndryshme

Armend Zemaj, ua përkujtoi të pranishmëve vërejtjet dhe sugjerimet e kryeparlamentarit për mospraninë e deputeteve gjatë seancës plenare, e sidomos në kohën e votimit të ligjeve, rekomandimeve, për zgjedhjen e anëtareve të bordeve etj, duhet të mendojmë se çka duhet ndërmarrë dhe si të zgjidhet kjo dukuri, e cila po përsëritet me mospraninë e deputetëve në seanca plenare.

Ardian Gjini, theksoi se duhet të gjendet një mënyrë për sanksionimin e deputetëve për mospjesëmarrje në seancë plenare, ngase mosvotimi është abstenim, por deputeti duhet të jetë i pranishëm në seancë plenare.

Armend Zemaj, në vazhdim theksoi se është kërkuar që të bëhet evidentimi (pasqyra) i 7 legjislacioneve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Të shikohen listat përfundimtare për koston buxhetore nga stafi administrativ i Kuvendit, duhet të bëhet seleksionimi i listave të deputetëve, sipas moshës edhe të drejtat jashtë Parlamentit, ku duhet të ngritet niveli i përgjegjësisë së dyanshme dhe mundësia për qasje në përgjegjësitë tjera, e jo vetëm gjatë seancës plenare. Kjo çështje do të diskutohet si pikë e veçantë e rendit të ditës.

Kryetari njoftoi se OSBE-ja ka shprehur gatishmëri të organizojë punëtori, me qëllim të vazhimit të Shqyrtimit të Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

Nënkomisioni u pajtua që punësia të mbahet më 27 mars 2013, në ambientet e lokalit “Amazonë”, në Milloshevë.

Nënkomisioni u pajtua që mbledhjet të mbahen sa më shpesh, me qëllim që të përfundohet sa më parë varianti përfundimtar i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

Mbledhja përfundoi në orën 11.30.

Kryetar i Nënkomisionit

Armend Zemaj

